



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAAFTËSISË

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, Datë ____/____/2025

PËR

MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN SHKURT 2025.

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”; Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115 datë 24.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr1, datë 11.02.2025 “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6 % të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato, që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 81 (tetëdhjetë e një) familje me një fond prej 332.917 (treqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.
2. Miratimin e heqjes nga skema e ndihmës ekonomike për këtë muaj gjithsej -0- familje nga fondi i Bashkisë si më poshtë:

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtore

Alneida Rroshi



DREJTORIA SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtore

Meme Xhaferaj



KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAAFTËSISË

RELACION

PËR

**MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA
FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOKNDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE
FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN SHKURT 2025.**

Gjatë muajit Shkurt në zyrat e Drejtorisë së Shërbimit Social të vendosura pranë 11 Njësive Administrative të Bashkisë Durrës kanë paraqitur kërkesat e tyre 90 familje për t'u trajtuar me pagesë për Ndhimë Ekonomike.

Përfitues të Ndhimës Ekonomike do të jenë 81 familje, me një fond prej 332.917 lekë me të ardhurat e Bashkisë Durrës.

Për muajin **Shkurt** sipas arsyeve të paraqitura hiqen nga Skema e Ndhimës Ekonomike gjithsej- **0-familje**.

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ", Ligjit nr. 57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025"; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.1, datë 11.02.2025 "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato, që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor", familjet që kërkojnë të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

Deklaratën tip për gjendjen social – ekonomike që plotësohet një herë në vit- **0-familje**.

Deklaratën -mujore- **0-familje**.